

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E RAHOVECIT OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	---	---

Për:	Grup i Operatorëve Ekonomik: LIMITPROJECT SH.P.K.; DELTA - CCD SH.P.K.; Rinesa SH.P.K.; AURA INVEST SH.P.K., Skenderbeu Q.Zej.E-3-5, - 13000, Glogoc Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	21.08.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A, paragrafi 10.1 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 63 paragrafi 1 të Rregullores **Nr. 001/2022** për Prokurim Publik, sa i përket **Kërkesës për Rishqyrtim** të datës: **16.08.2023**, të parashtruar nga **Grup i Operatorëve Ekonomik: LIMITPROJECT SH.P.K.; DELTA - CCD SH.P.K.; Rinesa SH.P.K.; AURA INVEST SH.P.K.** me adresë në **Glogoc**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **NDËRTIMI I QENDRËS RINORE DHE KULTURORE NË RAHOVEC**, me Numër të prokurimit: **623-23-2255-5-1-1**, Numër i brendshëm: **623-23-031-5-1-1**, nxjerr:

VENDIM

- I. **HEDHET POSHTË** si e pa bazuar Kërkesa për rishqyrtim e parashtruar nga **Grup i Operatorëve Ekonomik: LIMITPROJECT SH.P.K.; DELTA - CCD SH.P.K.; Rinesa SH.P.K.; AURA INVEST SH.P.K.** me adresë në **Glogoc**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **NDËRTIMI I QENDRËS RINORE DHE KULTURORE NË RAHOVEC**, me Numër të prokurimit: **623-23-2255-5-1-1**, Numër i brendshëm: **623-23-031-5-1-1**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK-së, të datës: **16.08.2023**, të publikuar në ueb – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- II. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me me hapat e mëtejshëm për këtë aktivitetin të prokurimit
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

ARSYETIM

Grup i Operatorëve Ekonomik: LIMITPROJECT SH.P.K.; DELTA - CCD SH.P.K.; Rinesa SH.P.K.; AURA INVEST SH.P.K. me adresë në Glllogoc, me datë: **16.08.2023** si palë e pakënaqur ka deponuar Kërkesë për Rishqyrtim pran AK Komuna e Rahovecit, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **NDËRTIMI I QENDRËS RINORE DHE KULTURORE NË RAHOVEC**, me Numër të prokurimit: **623-23-2255-5-1-1**, Numër i brendshëm: **623-23-031-5-1-1**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ - Komuna e Rahovecit, kundër Njoftimit mbi Vendim të AK-së të publikuar me **16.08.2023** në linkun <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

BAZA LIGJORE PËR REFUZIM TË KËRKESËS

Përgjigjja e AK ndaj Pretendimeve Ankimore;

Ju sqarojmë se pretendimet e tuaja ankimor nuk qëndrojnë dhe janë të pabazuar, pasi që vlerësimi i ofertave është bërë konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik Autoriteti Kontraktues: Komuna e Rahovecit, ju ka Njoftuar juve si Operator Ekonomik ankues, sipas formularit **B42 Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar**, ku nuk e keni plotësuar këto kriter sipas Njoftimit për Kontrate/Dosjes se tenderit:

Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Kërkesa 1: Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit

Kontraktues se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve te fundit, në vlerë jo më pak se: 5,960,000.00 Euro - Ne rast koncersiumi lideri duhet te ketë te paktën: 51 % te vlerës se qarkullimit.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Dëshmia 2: Deklaratat Tatimore vjetore të dorëzuara në ATK ose Raport nga Banka e vulosur dhe e nënshkruar origjinale nga ndonjë banke e licencuar ne Kosovë;

Sqarimet janë si në vijim:

Në ofertën e juaj të dorëzuar, qarkullimi i prezantuar ne emër te Grupit te Operatorëve Ekonomik:

- a. LIMITPROJECT SH.P.K. është në vlerë prej: 3,592,999.50 Euro;
- b. DELTA - CCD SH.P.K. është në vlerë prej: 513,522.84 Euro;
- c. Rinesa SH.P.K. është në vlerë prej: 1,627,090.97 Euro;

Ku gjithsej totali i qarkullimit të prezantuar nga ana juaj është në vlerë prej: 5,733,613.31 Euro; kurse në Dosje te tenderit është kërkuar, qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve te fundit, në vlerë jo më pak se: 5,960,000.00 Euro, andaj oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme konform nenit 59.4 të LPP-së

Dëshmitë mbi gjendjen ekonomike dhe financiare nuk përmbushin kërkesat minimale	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	68
---	---	----

Kapaciteti teknik dhe profesional:

Kërkesa 4: Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme, në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, në vlerë min. 4,474,500.00 €;

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Dëshmia 4: Lista e projekteve të kryera, duke plotësuar ANEKSIN 7 të Dosjes së Tenderit, në lëmin e punëve të ngjashme, të realizuar në tri vitet e fundit, nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik, DHE dëshmitë e përfundimit, Referenca/t ose Certifikata për Kryerjen e Punëve, Në rast se Operatori Ekonomik prezanton kontrata dhe referenca që janë të kontraktuara me subjekte private kombëtare ose ndërkombëtare, atëherë ato duhet të prezantohen Situacionet e nënshkruara së bashku me transaksionin bankar, që përputhet me të Njëjtën kontratë – Referencë;

Sqarimet janë si në vijim:

Në ofertën e juaj të dorëzuar, Referenca/t ose Certifikata për Kryerjen e Punëve në emër të Grupit të Operatorëve Ekonomik, të prezantuar janë kështu:

- a. LIMITPROJECT SH.P.K. është në vlerë prej: 1,075,999.00 Euro;
Referenca/t të dorëzuar me Kompaninë: BRT SHPK, në vlerë prej: 50,000.00 Euro, për punë të kryera në lëmin e punëve të njëjta, janë të pa pranuar për ne si AK, pasi që nuk janë dorëzuar Situacionet e nënshkruara së bashku me transaksionin bankar, sipas Dëshmisë me nr. 4, dhe nuk mund të përsëritet apo të kërkohet një dokument në bazë të Nenit 72, pasi që është precizuar në Dosjen e Tenderit, ku kemi cekur: Në rast se Operatori Ekonomik prezanton kontrata dhe referenca që janë të kontraktuara me subjekte private kombëtare ose ndërkombëtare, atëherë ato duhet të prezantohen Situacionet e nënshkruara së bashku me transaksionin bankar, që përputhet me të Njëjtën kontratë – Referencë;
- b. DELTA - CCD SH.P.K. është në vlerë prej: 502,517.16 Euro;
- c. Rinesa SH.P.K. është në vlerë prej: 65,371.88 Euro;
- d. AURA INVEST SH.P.K. Referenca/t të dorëzuar janë me Kompanitë private, për punë të kryera në lëmin e punëve të njëjta, të cilat janë të pa pranuar për ne si AK,

pasi qe nuk janë dorëzuar Situacionet e nënshkruara së bashku me transaksionin bankar, sipas Dëshmisë me nr. 4, dhe nuk mund te përsëritet apo te kërkohej një dokument ne baze te Nenit 72, pasi qe është precizuar ne Dosjen e Tenderit, ku kemi cekur: Në rast se Operatori Ekonomik prezanton kontrata dhe referenca që janë të kontraktuara me subjekte private kombëtare ose ndërkombëtare, atëherë ato duhet të prezantohen Situacionet e nënshkruara së bashku me transaksionin bankar, që përputhet me të Njëjtën kontratë – Referencë;

Ku gjithsej totali i Referenca/t ose Certifikata për Kryerjen e Punëve ne emër te Grupit te Operatorëve Ekonomik, të prezantuar janë në vlerë prej: 1,643,888.06 Euro; kurse në Dosje te tenderit është kërkuar, në vlerë min. 4,474,500.00 €, andaj oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme konform nenit 59.4 të LPP-së

Bazuar në tabelarin e UDHËZUES Nr. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK, në faqen 40 kemi shembullin se si duhet vepruar:

Lista e kontratave të realizuara e dorëzuar nuk përmbush kërkesat minimale të vlerës se përcaktuar	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtjshëm	69
--	--	----

Kapaciteti teknik dhe profesional:

Kërkesa 8: Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë te domosdoshme për realizimin e projektit, pajisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin 8 te Dosjes se Tenderit;

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Dëshmia 8: Pajisjet të cilat regjistrohen duhet të dëshmohen me librezën e regjistrimit (pajisjet duhet te jene me afat te regjistrimit), ndërsa pajisje tjera Operatori Ekonomik duhet ti dëshmoj me një dokument për pronësinë e pajisjeve (faturë, DUD etj). Vëmendje! Ne rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet te ofroj marrëveshjen për marrjen me qira te pajisjeve. Marrëveshja duhet te jete ne emër te këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga te dyja palët. Marrëveshja duhet te jete e noterizuar ne mes te qiradhënësit dhe qiramarrësit.

Sqarimet janë si në vijim:

Në ofertën e juaj të dorëzuar, nuk keni dorëzuar Listën e pajisjet dhe mekanizimi të obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin 8 te Dosjes se Tenderit, duke plotësuar ANEKSIN 8 të Dosjes se Tenderit, ku dokumenti ne fjale nuk mund te kërkohej ne baze te Nenit 72, paragrafi 3. ku thotë: Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive, andaj oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme konform nenit 59.4 të LPP-së

Krijimi i një grupi të operatorëve ekonomik

- a. **një deklaratë e qartë** ku të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e grupit të tenderit dhe, në rast se grupit i epet kontrata, për ekzekutimin e kontratës
- b. **një deklaratë të nënshkruar nga secili anëtarët**, duke konfirmuar pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk janë duke marrë pjesë në mënyre individuale dhe/apo në ndonjë grup tjetër që marrin pjesë në procedurën e njëjtën të prokurimit;
- c. **një deklaratë të nënshkruar** nga të gjithë anëtarët e grupit të cilët autorizojnë partnerin kryesor për të vepruar në emër të grupit, dhe
- d. Të gjitha anëtar e grupit të tillë duhet të **jenë të përshtatshëm** dhe do të sigurojnë dëshminë mbi përshtatshmërinë e tyre, siç është përmendur në paragrafin 6.4 të kësaj FDT.

Në ofertën e juaj të dorëzuar, nuk keni dorëzuar marrëveshjet për Krijimin e një grupi të operatorëve ekonomik;

Bazuar në tabelarin e UDHËZUES Nr. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK, në faqen 40 kemi shembullin se si duhet vepruar:

Mungon deklaratat e qartë ku të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtjshëm	Kusht administrativ
Mungon deklaratat e nënshkruar nga secili anëtar për konfirmim të pjesëmarrjes	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtjshëm	Kusht administrativ
Mungon deklaratat nënshkruar nga të gjithë anëtarët e grupit për autorizim të partnerit udhëheqës	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtjshëm	Kusht administrativ

Andaj oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme konform nenit 59.4 të LPP-së

Vlera e Parashikuar për këtë aktivitet të prokurimit është: 2,983,063.00 Euro, ndërsa oferta juaj është: 3,250,751.74 €, ku Oferta juaj përmban çmim të cilin e tejkalon buxhetin e Autoritetit Kontraktues për këtë aktivitet të prokurimit;

Nga konstatimet e lartcekur u vendos si në dispozitave të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij **vendimi të AK-së ju munde të paraqitni** ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

Astrit Mullabazi
Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Komuna e Rahovecit